



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

**VENDIM
Nr. 541, Datë 04.09.2018**

“Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 531, datë 25.06.2018 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes "EKMA Albania" SHPK, në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro-Ushqimore në qytetin e Tiranës”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Z. Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj. Leida MATJA	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 04.09.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 531, datë 25.06.2018 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes "EKMA Albania" SHPK, në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro-Ushqimore në qytetin e Tiranës”

Bazë ligjore: Neni 9, Neni 24, shkronja (d), neni 26 dhe neni 43 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi procedurën e hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes "EKMA Albania" SHPK, në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro-Ushqimore në qytetin e Tiranës,

VËREN SE:

1. Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të Ligjit Nr. 9121/2003, me anë të Vendimit Nr. 531, datë 25.06.2018 "Mbi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes "EKMA Albania" SHPK, në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro-Ushqimore në qytetin e Tiranës", vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes "EKMA Albania" SHPK, në tregun

e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro-Ushqimore në qytetin e Tiranës, për periudhën kohore nga 01.01.2017 deri në 01.05.2018. Sipas pikës 3 të këtij vendimi, Raporti i hetimit të thelluar duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se data 31 Korrik 2018.

2. Në zbatim të vendimit të mësipërm të Komisionit të Konkurrencës, bazuar në nenet 35 dhe 36 të Ligjit Nr. 9121/2003 dhe Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 327, datë 22.05.2018 "Autorizim inspektorësh", u kryen inspektime pranë ndërmarrjes EKMA Albania SHPK.
3. Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenet 33 dhe 34 të Ligjit nr. 9121/2003 janë kërkuar të dhëna dhe informacion nga: Bashkia Tiranë dhe Ndërmarrja "EKMA Albania" SHPK.
4. Koha e mbetur në dispozicion është e pamjaftueshme për përpunimin, vlerësimin dhe kryerjen e analizave të thelluara lidhur me sjelljen së ndërmarrjes EKMA Albania SHPK në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro-Ushqimore në qytetin e Tiranës, duke bërë të pamundur përfundimin e procedurave dhe dorëzimin e raportit të hetimit të thelluar brenda afatit.
5. Komisioni i Konkurrencës çmon se realizimi i plotë i procedurave të hetimit të thelluar me qëllim analizimin e sjelljes së ndërmarrjes EKMA Albania SHPK, është i domosdoshëm për të siguruar një vendimmarrje objektive.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 9, nenin 24, shkronja (d), nenin 26 dhe nenin 43 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës",

VENDOSI:

- I. Në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 531, datë 25.06.2018 "Mbi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes "EKMA Albania" SHPK, në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro-Ushqimore në qytetin e Tiranës", pika "3", të ndryshohet si vijon:
"3. Raporti i hetimit të thelluar duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se data 12 Tetor 2018."
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS